



PROCESVERBAL
Nga mbledhja e II-të (I-rë për v. 2010) e Kuvendit Komunal në Vushtrri
mbajtur më 28.1.2010

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën 10:00.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: z. Bajram Mulaku, kryetar i Komunës, znj. Xhevahire Izmaqu-nënkryetare e Komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Në vazhdim, para se të kalohet në rend të ditës z. Abdullah Halimi dhe Selim Rustemi dhanë betimin solemn dhe në këtë mënyrë u bënë anëtar të Kuvendit, duke e zëvendësuar z. Naim Hyseni dhe Dibran Perçuku, të cilët kanë dhanë më heret dorëheqje nga posti i këshilltarit në Kuvendin Komunal në Vushtrri.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili pasi konstatoi se ka kuorum për punë, propozoi këtë:

REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e inauguruese e KK-së mbajtur më 30.12.2009.**
2. **Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2010;**
3. **Propozim-Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2010;**
4. **Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Pavarur “Deloitte” për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2008;**
5. **Shqyrtimi i Raportit final i Auditorit të Komunës për rishikim të taksës në firmë në Drejtorinë për Buxhet e Financa për periudhën 01.01.2008-30.06.2009;**
6. **Shqyrtimi i Raportit Final të Auditorit të Komunës për vlerësimin e sistemit të kontrolleve të brendshme, planifikimin dhe realizimin e të hyrave në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Kadastër;**
7. **Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formim të Komitetit për Politikë dhe Financa;**

8. **Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formim të Komitetit për Komunitete;**
9. **Shqyrtimi i Propozim-Skemës organizative të Komunës për vitin 2010;**

z. Ismet Gashi-propozoi që pika e nëntë e rendit të ditës të propozuar të heqet nga rendi i ditës, pasi që e njëjta është propozuar nga personi i paautorizuar (jo kompetent), sepse skemën organizative duhet ta propozoi Kryetari i Komunës e jo Kryesuesi i Kuvendit, si dhe është dashtë që të ketë një fletë përcjellëse dhe i mungon arsyetimi për të dhënë sqarimet e duhura se skema e propozuar është e bazuar në norma ligjore të cilat janë në fuqi.

z. Idriz Muzaqi-skema organizative e propozuar është e bazuar në Statut të Komunës.

z. Ismet Gashi-kontestova kompetencën e propozuesit, për ndryshe edhe emërtimet e drejtorive komunale nuk janë shkruar konformë statutit të Komunës.

z. Sabit Kadriu-nuk mbështes propozimin që kjo pikë e rendit të ditës të heqet nga rendi i ditës, por që gjatë diskutimeve duhet të vendosim se a do ta aprovojmë si të tillë apo do të bëjmë ndryshime.

Në vazhdim, Kuvendi pas votimit, me shumicë votash “për”, një kundër dhe dy vota abstenim, aprovoi rendin e propozuar të ditës së bashku me propozimin e z. Gashi, që nga rendi i ditës të hiqet pika nr.9.

- 1) **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja inaguruese e KK-së mbajtur më 30.12.2009.**

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit, njëzëri, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet procesverbali nga mbledhja inaguruese e KK-së, mbajtur me 30.12.2009, pa vërejtje dhe sugjerime.

- 2) **Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2010.**

z. Bajram Mulaku-Kryetar i Komunës, paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me Planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2010.

z. Sami Istrefi-fillimisht në emër të Grupit parlamentar të PDK-së përkrahu Planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2010. Në vazhdim paraqiti këto propozime dhe sugjerime lidhur planin e punës në fjalë:

Faqe pesë, te Administrata komunale, të parashihen mjete financiare për ngritjen e performansës së shërbyesve civil (stafit);

Te Arsimi, të parashihen mjete financiare për rregullimin e oborreve të shkollave si dhe për gjelbërimin e tyre.

z. Qazim Azemi- pasi propozoi që në faqe 2, te prioritetet e cekura, të futet si prioritet edhe Arsimi, pyeti se te projekti për meremetimin e SHMP “Latif Berisha” (faqe 6), a kemi të bëjmë me vazhdimin e projektit i cili është realizuar apo kemi të bëjmë me projekt të ri, sepse e dimë se meremetimi i kësaj shkolle është bërë.

Faqe 3, te bujqësia, propozoi që të merren masa për mbrojtjen e tokës bujqësore në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe organet tjera kompetente.

Sa i përket Kulturës kërkoi ti ipet prioritet çështjes së bibliotekave.

z. Pajazit Pllana-duke ju referuar planit në fjalë në lëmin e shëndetësisë theksoi se mungon plani për ndërtimin e një QKMF në qytet që është e domosdoshme kur kemi parasysh numrin e banorëve në qytet dhe faktin se kemi vetëm një qendër të tillë. Gjithashtu, ceku se objekti ku është e vendosur ambulanca në fshatin Samadrexhë është në gjendje të rëndë prandaj është dashtë të parashihet ndërtimi i një objekti të ri.

Sa i përket Kulturës, është dashtë të jetë paraparë ngritja e Shtatores së Hasan Prishtinës në qytetin e Vushtrrisë, në planin e punës kjo mungon.

z. Sabit Kadriu-pasi ceku se përkrahu në parim Planin e punës te kryetarit te Komunës për vitin 2010, theksoi se duhet ti japim rëndësi bujqësisë, prandaj propozoi qe te formohet drejtoria për bujqësi ne Komunën e Vushtrrisë. Ne vazhdim pyeti lidhur me

projektin për renovimin e ndërtesës së Komunës (faqe 7), se për qfar renovimi behet fjale pasi që e dimë se disa herë është bërë renovimi i këtij objekti. Kur behet fjalë për subvencionim të bujqësisë ku janë parapare 20000€, shtrohet pyetje a janë të mjaftueshme këto mjete për këtë qëllim.

Sa i përket Arsimit dhe Kulturës, duhet të mendojmë për pajisjen e shkollave me laboratorë përkatës, duhet të mendojmë për ndërtimin e një biblioteke në qytet si dhe për formimin e bibliotekave nëpër shkolla.

z. Refik Ramaj-paraqiti këto vërejtje dhe sugjerime lidhur me Planin e punës të kryetarit të Komunës për vitin 2010:

Faqe 2, të prioritetit baze, prioriteti 3, përmirësimi i ambientit për komunitetin e biznesit, ky prioritet nënkupton edhe prioritetet e cekura në vazhdim, atë 4,5 dhe 6;

Pas pikës 7, të prioritetit baze, propozoi të jetë Kualifikimi i pasqyrave financiare të Komunës;

Të prioritetit në ekonomi, propozoi që prioriteti i parë të jetë përmirësimi i rrethinës ekonomike e jo si është shkruar përmirësimi i infrastrukturës ekonomike;

Faqe 2, të rritjes së hyrësve buxhetore të Komunës, propozoi që të hiqet termi donacion, të jetë formulimi...përmes formave të financimit qoftë edhe përmes donacioneve;

Të tërheqja e investimeve të huaja propozoi që të hiqet pika e fundit;

Të bujqësia duhet të jetë prioriteti formimi i drejtorisë së bujqësisë.

z. Muharrem Shabani-është mirë që kemi një plan të punës të Kryetarit të Komunës pasi që me parë një plan të tillë nuk e kemi pasur. Sa i përket prioritetit të cekur në planin (faqe 2), në këto prioritet duhet të jenë edhe arsimit dhe kultura. Sa i përket parkut të biznesit i cili është parapare të ndërtohet në Lumëmadh, mendoj se duhet të gjendet një hapësirë tjetër për këtë qëllim në mënyrë që të mos zihet toka pjellore që është në këtë vend. Mbështes propozimet e parafolësve lidhur me formimin e drejtorisë për Bujqësi pasi që një gjë e tillë është e nevojshme. Në vazhdim theksoi se Komuna nuk është kompetente për të formuar Entin Kombëtar të patates si që është parapare në planin e punës të kryetarit të Komunës. Gjithashtu, kërkoi që të kemi një zhvillim harmonik të Komunës e jo të favorizohen regjionet e caktuara brenda Komunës. Si dhe kërkoi të kemi Planin e punës të Prokurimit, planin e investimeve për vitin 2010 dhe planin e punës të auditorit të Komunës.

znj. Bahrije Pllana-pasi cekur se me vjen mirë që në planin e punës të kryetarit të komunës për vitin 2010 ceket fuqizimi i rolit të gruar, pyeti se a është respektuar kjo me rastin e emërimit të drejtorëve të drejtorive komunale.

z. Zeqir Hasani-të prioritetit në ekonomi, propozoi të hiqet termi "politikë tatimore", ndërsa sa i përket ndërtimit të parkut të biznesit, propozoi që i njëjti të mos ndërtohet në Lumëmadh por të gjendet një hapësirë tjetër. Në vazhdim kërkoi që të kushtohet një rendësi më e madhe diasporës pasi që në planin e punës nuk është përmendur fare. Në fund theksoi se në planin e punës është cekur rritja e punësimit por nuk është cekur se në qfar forme do të behet kjo rritje.

z. Besim Jashari-mbështes të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e paraqitura të argumentuara të paraqitura nga parafolësit lidhur me Planin e punës të kryetarit të Komunës për vitin 2010. Në fund cekur se në planin e fjalës është dashtë të ceket rikthimi i pronës komunale, mbrojtja e pyjeve, bashkëpunimi i institucioneve komunale me ato qendrore si dhe integrimi i komuniteteve në komunën tonë.

z. Bajram Mulaku-në përmbajtje të diskutimeve lidhur me Planin e punës të kryetarit të Komunës për vitin 2010 falënderoi të gjithë këshilltarët komunal për vërejtjet dhe sugjerimet e paraqitura lidhur me këtë planë duke u zotuar se të gjitha ato sugjerime që janë në interes të qytetareve të Komunës sonë do të inkorporoi në Planin e punës për vitin 2010.

3) Propozim-Plani i punës se Kuvendit të Komunës për vitin 2010.

z. Ferit Idrizi-kryesues i Kuvendit të Komunës, paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me Planin e punës të Kuvendit për vitin 2010.

z. Qazim Azemi-pasi propozoi që në faqe tre të Planit të punës të cekën detyrat e Kuvendit, theksoi se për muajin dhjetor duhet të ceket një obligim i kryetarit të Komunës për të mbajtur një tubim publik me qytetar pasi që për një gjë të tillë e obligon Ligji për Vetëqeverisjen e Komunave.

z. Sami Istrefi-propozoi që në planin e punës të Kuvendit për vitin 2010 të cekën Planet e punës të Auditorit të Komunës si dhe Plani i punës i drejtorisë së Prokurimit.

z. Besim Jashari-pjesë e Planit të punës të Kuvendit për vitin 2010 duhet të jetë edhe Plani vjetor për transparencë si dhe marrja e vendimeve për shprehjen e interesit të përgjithshëm të Komunës për disa prona në Komunën e Vushtrrisë (stacioni i autobusëve), si dhe gjetja e një lokali (zyre) për punë të këshilltarëve komunal gjegjësisht për shëfat e grupeve parlamentare. Në planin e punës duhet të ceket edhe obligimi i komiteteve gjegjëse, të Zyrës për Integritet evropian etj. për të raportuar për punën e tyre para Kuvendit.

z. Muharrem Shabani-në Planin e punës të Kuvendit duhet të parashihet edhe Plani i punës së Prokurimit si dhe Plani i Investimeve për vitin 2010.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit, njëzëri, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet Plani i Punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2010.

4) Shqyrtimi i raportit final i Auditorit të Pavarur “Deloitte” për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2008.

z. Refik Ramaj-fillimisht theksoi se asnjë koment i Komunës gjegjësisht rekomandim i paraqitur lidhur me auditimin e bërë nuk është marrë parasysh nga ana e auditorëve. Në vazhdim theksoi se është e papranueshme që komuna në fund të vitit 2008 të mos ketë pasqyrat financiare, prandaj kualifikimi i pasqyrave financiare duhet të jetë prioritet. Shumica e vërejtjeve të cekura në raportin final të Auditorit të pavarur kanë qenë edhe në vitin 2007 dhe të njëjtat nuk janë evituar as në vitin 2008. Në vazhdim theksoi se duhet të bëhet regjistri i saktë i aseteve të komunës për të cilin regjistër nuk nevojitet shumë punë. Duke folur lidhur me të gjeturat e auditorit në drejtorinë e Prokurimit theksoi se kjo drejtori nuk ka aplikuar penalet për vonesë në kryerjen e punëve me rastin e realizimit të dy projekteve: projekti për asfaltimin e rrugës “Dëshmorët e Kombit” dhe të projektit për rregullimin e shtratit të lumit “Terstena” në Vushtrri. Në fund kërkoi të bëhet Plani për implementimin e rekomandimeve të paraqitura në raportin në fjalë si dhe ky planë të implementohet.

z. Muharrem Shabani-pasi ceku se rekomandimet e paraqitura në raportin në fjalë dhe zbatimi i tyre janë në interes të komunës theksoi se duhet të bëhet plani për implementimin e rekomandimeve dhe për këtë të informohet Kuvendi. Në fund kërkoi që për seancën e ardhshme të kemi Planin për implementimin e rekomandimeve të paraqitura në raportin e auditorit të pavarur.

z. Besim Jashari-pasi ceku se rekomandimet e paraqitura nga ana e auditorit të pavarur po përsëriten nga viti në vit, që tregon se nuk kemi të instaluar sistemin e llogaritjes, theksoi rëndësinë e funksionalizimit të komisionit të auditimit të brendshëm i formuar kohe më parë nga Kuvendi.

z. Fadil Muzaqi-theksoi se gjatë realizimit të projekteve po hasim në probleme të ndryshme (probleme pronësore, kushtet meteorologjike etj.) që ndikojnë në vonesë në kryerjen me kohë të projektit. Në rastin konkret auditori ka marrë për bazë vetëm datën e fillimit dhe të mbarimit të projektit e jo edhe ditarin e punës. Sa i përket projektit për rregullimin e shtratit të lumit “Terstena” ky projekt ende është në realizim e sipër prandaj në këtë rast nuk mundemi të aplikojmë penalet për vonesë në realizimin e tij.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit, njëzëri, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Përkrahen rekomandimet e paraqitura ne Raportin e Auditorit të Pavarur “Deloitte” për pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2008, dhe lidhur me këtë kërkon që të bëhet plani për implementimin e tyre.

Në vazhdim pika nr. 5 dhe 6 u shqyrtuan së bashku.

5) Shqyrtimi i raportit final i auditorit te Komunës për rishikim te taksës ne firmë në Drejtorinë për Buxhet e Financa për periudhën 01.01.2008-30.06.2009.

6) Shqyrtimi i raportit final te auditorit te Komunës për vlerësimin e sistemit të kontroleve të brendshme, planifikimin dhe realizimin e të hyrave ne Drejtorinë për Urbanizëm dhe Kadastër.

z. **Bedredin Mulaku**-paraqiti sqarimet hyrëse.

z. **Zeqir Hasani**-fillimisht theksoi se auditimi duhet të bëhet për një vit buxhetor e jo si në këtë rast për një periudhë të caktuar. Ne vazhdim duke ju referuar të dhënave të cekura në raport lidhur me pajisjen e bizneseve me leje të punës, kërkoj nga drejtoria kompetente që të merr masa te duhura për pajisjen e bizneseve me leje pune.

z. **Besim Jashari**-sugjeroi që në kuadër të Drejtorisë për Buxhet e Financave të formohet një Sektor për analize dhe planifikim.

7). **Shqyrtimi i propozim-vendimit për formim të Komitetit për Politike dhe Financa.**

z. **Ferit Idrizi**-kryesues i Kuvendit kërkoj një pushim prej 10 minutave për konsultim të shefave të grupeve parlamentare lidhur me përbërjen e KPF-ca.

Pas konsultimeve të bëra nga shefat e grupeve parlamentare është arritur marrëveshja që KPF-ca të ketë për momentin pesë anëtar, tre nga PDK-es, një nga AAK dhe një nga LDK, ndërsa pas ndryshimit te statutit te Komunës përbërja e KPF-se do te ketë 9 anëtar. Nga PDK-ës për anëtar te KPF-ca u propozuan Ferit Idrizi, Sami Istrefi dhe Gjylsime Feka, nga AAK, u propozua Bahrije Pllana ndërsa nga LDK Veli Karaqa.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit, me një vote “kundër” të tjerat “për”, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Formohet Komiteti për Politike dhe Financa ne këtë përbërje:

- *Ferit Idrizi, kryesues*
- *Sami Istrefi, anëtar*
- *Gjylsime Feka, anëtar*
- *Bahrije Pllana, anëtar*
- *Veli Karaqa, anëtar*

8) **Shqyrtimi i propozim-vendimit për formim te Komitetit për Komunitete**

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit, me një vote “kundër” të tjerat “për”, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Formohet Komiteti për Komunitete ne këtë përbërje:

- *Habibe Gergjaliu, anëtar*
- *Sabri Ferati, anëtar*
- *Selvete Sholla, anëtar*
- *Ergyn Sunguri, anëtar*
- *Andriana Disiq, anëtar*
- *Adem Hoti, anëtar*
- *Ferki Emmini, anëtar*

z. **Qazim Azemi**-bazuar ne nenin 39 te Ligjit për Vetëqeverisjen e Komunave dhe nenin 43 te Statutit te Komunes, kërkoj informatë me shkrim nga Kryetari i Komunës lidhur me

ndërrimin e emrit të SHMP “Latif Berisha” në Vushtrri, në çfarë forme dhe procedure është bërë ky ndërrim.

Mbledhja përfundoi në **ora 15:05**

Procesmbajtësi:
Ilmi Zeqiri

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi